

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQËRISË  
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“EMS Western Balkan” SHPK**

**TITULLI I  
EMRI I SHOQËRISË – SELIA – KOHËZGJAJTA**

Sot, më datë 21.08.2023 (*dymijë e njëzet e tre*), në mbështetje të legjislacionit shqiptar, respektivisht të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*“, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*” i përditesuar, themeluesit e përcaktuar si më poshtë, të cilët kanë krijuar Shoqërinë Tregtare me emërtimin “**EMS Western Balkan**” Sh.p.k. dhe me emrin tregtar: “**QuBit WB**”, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe që funksionon sipas të drejtës shqiptare, miratojnë këtë Statut të Shoqërisë:

**Neni 1 – Emri i Shoqërisë**

- 1.1 Shoqëria e quajtur “**EMS Western Balkan**” Sh.p.k (që këtu e më poshtë referuar si “Shoqëria”) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar themeluar dhe organizuar në përputhje me ligjin e Republikës së Shqipërisë.
- 1.2 Shoqëria Tregtare “**EMS Western Balkan**” shpk zotërohet nga Ortaku i vetëm themelues:
  - *Shoqëria Mantic Shpk, e krijuar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar në QKB dhe identifikuar me NIPT L91421018D, me seli në adresën Rruga “Ibrahim Rugova”, ndërtesa 42, hyrje 7, kati 5, ap 16, Tiranë, e përfaqësuar ligjërisht nga Administratori Z. Genti Daci, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, lindur me datë 25.06.1972 në Tiranë, identifikuar nga leternjoftimi me Nr. H20625148U.*
- 1.3 Shoqëria do të ketë emrin tregtar “**QuBit WB**”, vulën e saj zyrtare dhe logon.

**Neni 2 - Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën Rr: "Ibrahim Rugova", Ndërtesa Nr. 42, Hyrja Nr.7, Kati 5, Njesia Bashkiake Nr.5, Kodë Postar 1019, Tiranë, Shqipëri.

**Neni 3 – Kohëzgjatja**

- 3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është për një periudhë të pakufizuar.

**TITULLI II  
OBJEKTI**

**Neni 4 – Objekti**

- 4.1 Objekti i Shoqërisë përfshin, por pa u kufizuar vetëm në to, aktivitetet e mëposhtme:



- a. Tregti, import, eksport, shpërndarje me shumicë dhe pakicë si dhe për lidhje internet me çdo material të produkteve elektrike dhe elektronike.
- b. Ruajtjen, transportin, përpunimin dhe deponimin e mbeturinave nga pajisjet elektrike ose elektronike, si nga individë privatë edhe nga biznese.
- c. Prodhimi, instalimi, mbledhje, çmontimi dhe rigjenerimin e produkteve elektrike dhe elektronike, duke përfshirë ato në industrinë e kompjuterave, telefonisë dhe pajisjeve video, si dhe asistencë teknike lidhur me to edhe nëpërmjet trajnimit teknik për palët e treta.
- d. Zhvillimi i çdo aktiviteti tjetër të lidhur me sa më sipër, që janë plotësuese ose të ngjashme me ato.
- e. Shoqëria do të kryejë aktivitetet në fushën e përpunimit aktiv.
- f. Për përmbushjen e objektit të veprimtarisë, shoqëria mund të marrë pjesë në mënyrë direkte apo indirekte në interesa apo pjesëmarrje në shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtë ose të përafërt me të sajën dhe mund të kryejë direkt apo indirekt të gjitha operacionet tregtare, financiare, me karakter të luajtshmëm si dhe të japë garanci palëve të treta.

### TITULLI III KAPITALI

#### KUOTAT – TRANSFERIMI I KUOTAVE

##### **Neni 5 – Kapitali**

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë, i miratuar nga Ortaku i vetëm themeules dhe ndahet në 1 (një) kuotë të vetme me vlerë nominale të barabartë me 100,000 (njëqind mijë) Lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë.
- 5.2 Kapitali është nënshkruar dhe paguar plotësisht dhe pjesëmarrja e Ortakut në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij, si më poshtë:
  - a) **Shoqëria Mantic Shpk** është zotëruar i një kuote me vlerë nominale 100,000 (njëqind mijë) Lekë, që përfaqëson 100 % të kapitalit të Shoqërisë;

##### **Neni 6 – Zmadhimi i Kapitalit**

- 6.1 Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me një vendim nga Asambleja e Përgjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave.
- 6.2 Ortakët mund të financojnë Shoqërinë nëpërmjet financimeve me pagesa, me interes dhe/ose pa interes, si kontribut në kapital ose jo si kontribut në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 6.3 Shoqëria mund të zmadhojë kapitalin nëpërmjet financimeve të ortakëve të Shoqërisë në rastet kur do të jetë e nevojshme.

##### **Neni 7 – Zvogëlimi i Kapitalit**

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogelojë kapitalin e Shoqërisë në përputhje me dispozitat e legjislacionit të zbatueshëm. Në rast se kapitali i Shoqërisë zvogëlohet nën limitin e përcaktuar nga Ligji Shqiptar, Shoqëria duhet të ndryshojë formën e saj ligjore.

##### **Neni 8 – Pjesëmarrje në Kapitalin Themeltar**



- 8.1 Pjesëmarrja e Ortakëve në kapitalin themeltar përcaktohet në përputhje të drejtë me kontributet e tyre në kapitalin themeltar.
- 8.2 Të drejtat e Ortakëve përfshirë edhe të drejtën e votës, u takojnë në mënyrë përpjestimore me pjesëmarrjen që zotëron secili Ortakn në kapitalin themeltar.
- 8.3 Në rast tjetërsimi të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar jashtë Shoqërisë, Ortakët gëzojnë të drejtën e parablerjes. Me tjetërsim do të kuptohet çdo akt tjetërsimi i kuotave, në kuptimin më të gjërë të fjalës, si në pronësi të plotë ashtu edhe të pjesshme, në mënyrë direkte ose indirekte, që sjell ndryshimin e titullit të pronësisë mbi kuotat ose të drejtat mbi to. Ortaku i cili dëshiron të transferojë kuotën e tij tek palë të treta jashtë Shoqërisë, do të njoftojë ortakët e tjerë nëpërmjet një njoftimi me shkrim i cili duhet të përcaktojë dhe kushtet e transferimit. Ortakët e Shoqërisë njoftojnë qëllimin e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes brenda 30 ditëve nga njoftimi. Në rast se asnjë prej Ortakëve nuk e ushtron të drejtën e parablerjes brenda afatit të përcaktuar si më lart, atëherë Ortaku që kërkon të largohet ka të drejtë të transferojë tek palë të treta kuotën e tij dhe të drejtat mbi të. Ortaku që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjet në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga çasti i kalimit të kuotës deri në çastin e regjistrimit të kalimit.
- 8.4 E drejta e parablerjes nuk është e domosdoshmëri të ushtrohet prej Ortakëve në rastin e transferimit të plotë ose të pjesshëm të kuotave tek pjesëtarët e familjes së Ortakut duke përfshirë, prindër, fëmijë, bashkëshortë, motra apo vëllezër, apo në rastin e transferimit tek subjektet e zotëruara nga vetë Ortaku.

## **Neni 9 – Transferimi i Kuotave**

- 9.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të transferohen në përputhje me dispozitat e Ligjit.
- 9.2 Transferimi i kuotave të kapitalit në favor të personave të tretë kushtëzohet nga e drejta e parablerjes së Ortakëve.
- 9.3 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat e detyrimet që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen, apo kalohen nëpërmjet:
  - a. *Kontributit në kapitalin e Shoqërisë;*
  - b. *Shitblerjes;*
  - c. *Trashëgimisë;*
  - d. *Dhurimit;*
  - e. *Çdo mënyre tjetër e parashikuar me ligj;*
- 9.4 Transferimi i kuotës/ave të kapitalit tek palët e treta, pjesërisht apo tërësisht, me përjashtim të kalimit me dhurm apo trashëgimi, mund të bëhet vetëm pasi të ketë marrë vendim Asambleja e Përgjithshme, me anë të një kontratë shitjeje me shkrim dhe pasi të jenë plotësuar kushtet e të drejtës së parablerjes me një.

## **TITULLI IV SEKSIONI I ORGANET E SHOQERISE**

### **Neni 10 – Organet e Shoqërisë**

- 10.1 Organet vendimmarrëse dhe drejtuese të Shoqërisë janë:



- 1) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- 2) Administratori.

## SEKSIONI II ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

### Neni 11 – Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve (“*Asambleja e Përgjithshme*”) është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime në vende të ndryshme nga selia, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, në përputhje me parashikimet në këtë statut dhe dispozitat ligjore në fuqi. Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm që miraton çdo ndryshim të statutit sipas
- 11.2 E drejta e votës për secilin ortak është në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij/saj, e barazvlefshme me % e pjesmarrjes së secilit ortak në kapitalin themeltar të Shoqërisë. Çdo kuotë garanton të drejtën e nje vote në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve, të drejtën për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve dhe të drejtave të siguruara me ligj, me Statut apo me marrëveshje mes Ortakëve.
- 11.3 Asambleja është organi sovran i shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme thirret dhe me vendime të vlefshme sipas menyrës së përcaktuar në dispozitat e ligjit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Asambleja e Përgjithshme përcakton dhe miraton të drejtat dhe detyrat e organeve të saj. Të zgjedhurit dhe të emëruarit nga Asambleja veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij statuti, aktit të themelimit si dhe ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Vendimet që merr Asambleja sipas këtij statuti dhe legjisllacionit në fuqi janë të detyrueshme për çdo ortak. Asambleja thirret të paktën një herë në vit.
- 11.4 Secili ortak ka të drejtë vote sipas përqindjes në kuotën e kapitalit themelues të Shoqërisë dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, Asambleja e Përgjithshme merr vendime:
  - a. Me shumicë të zakonshme
  - b. Me shumicë të kualifikuar
  - c. Me unanimitet.
- 11.5 Për vendimet që kërkojnë shumicë të thjeshtë, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vlefshmërisht vendime me shumicë të zakonshme nëse janë të pranishëm ortakët te cilet përfaqësojnë më shumë se 30% të votave dhe vendimet merren me 50% + 1 të votave të Ortakëve pjesëmarrës. Në rastin kur ky kuorum nuk arrihet në thirrjen e parë, Asambleja e ortakëve do të thirret sërish me të njëjtin rend dite brenda dhe jo përtej 30 (tridhjetë) ditëve duke filluar nga thirrja e parë; kuorumi mbetet i njëjtë.
- 11.6 Për vendimet që kërkojnë shumicë të kualifikuar, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vlefshmërisht vendime, vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të votave janë të pranishëm dhe vendimet merren me 75% +1 të votave të Ortakëve. Në rastin kur ky kuorum nuk arrihet në thirrjen e parë, Asambleja e ortakëve do të thirret sërish me të njëjtin rend dite brenda dhe jo përtej 30 (tridhjetë) ditëve duke filluar nga thirrja e parë; kuorumi mbetet i njëjtë.
- 11.7 Merren vlefshmërisht me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve pjesëmarrës, vendimet që kanë si objekt çështjet në vijim:



- a. *Ndryshimet e statutit;*
  - b. *Rritja dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë;*
  - c. *Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;*
  - d. *Riorganizimin, transformimin apo prishjen e Shoqërisë;*
  - e. *Miratimi i projekteve të bashkimit dhe ndarjes;*
  - f. *Shpërndarja e fitimeve;*
  - g. *Marrje, dhënie kredie apo vendosje pengu, barrë hipotekore në emër dhe mbi pronësinë e Shoqërisë;*
  - h. *Politikat, vizionin, misionin apo parimet e Shoqërisë;*
  - i. *Nënshkrimin e kontratave dhe marrëveshjeve me palë të treta, për vlera që janë kufizuar të nënshkruhen nga Administratori, me Vendim të veçantë.*
- 11.8 Merren vlefshmërisht me shumicën e zakonshme të votave të ortakëve pjesëmarrës, vendimet që kanë si objekt çështjet në vijim:
- a. *Emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ëve dhe vendos për shpërblimin e tij/tyre;*
  - b. *Emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe të audituesit e vendos për shpërblimin e tyre;*
  - c. *Mbikqyrjen e zbatimit dhe të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;*
  - d. *Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;*
  - e. *Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë ndaj palëve të treta dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve;*
  - f. *Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;*
  - g. *Miraton lidhjen e marreveshjeve për huatë, blerjen e pajisjeve për nevojat e veta, investimet vjetore;*
  - h. *Miraton shit-blerjen e pasurive të paluajtshme;*
  - i. *Aprovon shit-blerjen e asetëve të Shoqërisë;*
  - j. *Vendos për nënshkruesit e autorizuar të llogarive bankare të Shoqërisë;*
  - k. *Vendos për nënshkrimin e marrëveshjeve midis Shoqërisë me Ortakun e saj ose Administratorin e Shoqërisë;*
  - l. *Aprovon nënshkrimin e marrëveshjeve midis Shoqërisë dhe një shoqërie tjetër kur Ortaku u njerës Shoqëri është Ortak ose Administrator në Shoqërinë tjetër;*
  - m. *Aprovon nënshkrimin e marrëveshjeve të cilat e ngarkojnë Shoqërinë me detyrime afatgjata, me shumë se një vit;*
  - n. *Jep autorizimin për Administratorin e Shoqërisë të nënshkruaje marrëveshjet e Shoqërisë me palët e treta për vlera me të mëdha se sa i janë lejuar Administratorit.*
  - o. *Aprovon strukturën organizative të Shoqërisë;*
  - p. *Hapjen apo mbylljen e adresave dytsore të Shoqërisë;*
  - q. *Aprovon Rregulloret administrative, procedurat operationale dhe rregulloret që nevojiten*
  - r. *Aprovon formatin e kontratës së punës, pagën për cdo kategori punonjësish;*
  - s. *Miraton Vendime per ceshtje te tjera te parashikuara nga Statuti ose marreveshja per themelimin e Shoqerise te cilat nuk jane ne kompetence te Administratorit;*
  - t. *Blerjen dhe shitjen e pjesemarrjes se koutave, akioneve ne shoqeri te tjera brenda dhe jashte vendit;*
  - u. *Miratimin e themelimit te shoqerive te tjera brenda apo jashte vendit;*

- v. *Miratimin e krijimit të joint ventures dhe bashkëpunimeve të cilitdo lloj qofshin që kanë të bëjnë me investim, financim, fitim të drejtash, apo pjesëmarrjesh në projekte ekzistuese apo të reja.*
- w. *Të vendosë për çdo çështje tjetër që i takon për zgjidhje asamblesë, me ligj apo sipas këtij statuti.*

## **Neni 12 - Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme dhe Procesverbalet**

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme e thirrur rregullisht në përputhje me Nenin 84 të Ligjit përfaqëson të gjithë ortakët dhe vendimet e saj, të marra konform ligjit dhe këtij statuti, përbejnë detyrim ligjor për të gjithë ortakët, edhe nëse mungojnë ose nuk janë të të njëjtit mendim.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori/ët apo ortakët e përcaktuar sipas ligjit në fuqi sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Ajo mund të thirret/mblidhet edhe jashtë selisë së Shoqërisë, por brenda territorit të Shqipërisë, me njoftim me letër rekomandë dhe/ose poste elektronike, dërguar ortakëve në vendbanimin që rezulton nga libri i ortakëve, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë Njoftimi për Ortakët duhet të përcaktojë mënyrën e mbledhjes, vendin, datën, orën dhe rendin e ditës. Ortakët kanë përgjegjësinë personale për të njoftuar Administratorin mbi të gjitha detajet e kontakteve dhe për ndryshimet e tyre dhe Njoftimet do të konsiderohen të rregullta nëse janë drejtuar në adresat e fundit të raportuara.
- 12.3 Asambleja mund të thirret gjithashtu edhe nga eksperti kontabël i autorizuar, nëse ka të tillë, ose nga një apo disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5 (pesë) për qind të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë.
- 12.4 Asambleja mund të thirret nga ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 (pesë) për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut. Ata mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin drejtpërdrejtë asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës dhe të kryejnë njoftimet perkatëse. Nëse, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
  - a. *të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;*
  - b. *t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre*
- 12.5 Në njoftimin e thirrjes së asamblese duhet të tregohen vendi, dita dhe ora e mbledhjes dhe lista/ rendi e/i çështjeve që do të trajtohen. Në mungesë të formaliteteve si më sipër asambleja konsiderohet e mbledhur rregullisht nëse në të përfaqësohet i gjithë kapitali themeltar dhe askush nuk kundërshton trajtimin e çështjeve të rendit të ditës. Asambleja drejtohet nga administratori.
- 12.6 Asambleja emëron një sekretar, edhe jo ortak dhe, nëse nevojitet, një ose disa vëzhgues, edhe jo ortakë. Kryetari i asamblesë konstaton mbledhjen e rregullt të saj, verifikon identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmeve, drejton dhe garanton zhvillimin e rregullt të mbledhjes së asamblesë si dhe verifikon dhe shpall rezultatet e votimeve.

- 12.7 Mbledhjet e asamblesë mund të mbahen edhe me video-konferencë ose në tele-konferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe të dallohen në çdo moment të lidhjes, dhe t'u lejohet të ndjekin diskutimin, të marrin, transmetojnë dhe/ose vëzhgojnë dokumentet, të ndërhyjnë gojarisht dhe në kohë reale mbi të gjitha çështjet, si dhe të marrin pjesë në votim dhe të bejne të mundur që vendimi të merret, në mënyrë të tillë që të mund të garantohet vendimarrja kolegjiale, zbatimi i parimeve të mirëbesimit dhe barazisë së trajtimit të ortakëve.
- 12.8 Në prani të kushteve të mësipërme, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e mbajtur rregullisht në vendin në të cilin gjendet drejtuesi i saj dhe ku duhet të ndodhet gjithashtu edhe sekretari, ku të mundësohet hartimi dhe nënshkrimi i procesverbalit në librin përkatës në përputhje me Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare..
- 12.9 Çdo ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe të votës në Asamblenë e Përgjithshme në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës që zotëron në kapitalin e Shoqërisë.
- 12.10 Ortakët mund të përfaqësohen në Asamble nga persona të tjerë, edhe jo ortak, nëpërmjet një prokure të posaçme të lëshuar konform dispozitave ligjore në fuqi; rregullshmëria e prokurës do të verifikohet nga Kryetari i asamblesë. Administratori smund të përfaqësojë ortakët.
- 12.11 Prokura është e vlefshme vetëm për asamblenë përkatëse për të cilën lëshohet, e cila identifikohet në bazë të rendit të ditës. Ortaku nuk mund të japë prokurë për të votuar për një pjesë të kuotave së tij në kapitalin e Shoqërisë, nëse voton personalisht për pjesën e mbetur.
- 12.12 Vota duhet të jetë e hapur ose gjithsesi e shprehur me modalitete të tilla që bëjnë të mundur identifikimin e ortakëve që nuk janë të të njëjtit mendim. Modalitetet e votimit miratohen nga asambleja, me propozim të Kryetarit, me shumicën e të pranishmëve.
- 12.13 Vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, të nënshkruar nga Kryetari dhe sekretari ose nga noteri, në rastet e parashikuara me ligj.
- 12.14 Vendimet e ortakëve do të mund të merren edhe nëpërmjet vendimit qarkullues me shkrim siç vijon.
- 12.15 Vendimet e propozuara, me iniciativën e një apo më shumë administratorëve apo të së paku një prej ortakëve, do t'i dërgohen të gjithë ortakëve, me cilindo mjet të shkruar, faks, telefax, poste elektronike apo postë të regjistruar.
- 12.16 Prej propozimit duhet të rezultojë qartë çështja objekt i vendimit qarkullues, arsyet dhe çka është e nevojshme për të siguruar një informacion të përshtatshëm mbi çështjen për t'u trajtuar, sikurse edhe teksti i saktë i vendimit për t'u marrë.
- 12.17 Secilit ortak do t'i kërkohet t'a dërgojë votën e tij me fax, poste elektronike apo telefax të konfirmuar me postë të regjistruar në dokumentin e dërguar, brenda afatit të treguar në propozim; mungesa e përgjigjes prej ortakëve brenda afatit të sipërpërmendur do të konsiderohet si votë kundër.
- 12.18 Vendimi do të konsiderohet i marrë kur:
- të gjithë ortakët kanë aprovuar paraprakisht diskutimin e çështjes objekt të vendimi qarkullues me shkrim dhe
  - miratimet me shkrim të ortakëve të arrijnë kuorumin e kërkuar prej statutit.
- 12.19 Vendimi duhet të jetë i qartë dhe i pakushtëzuar dhe nga ai duhet të rezultojë nëse votimi ka qenë pro apo kundër vendimit të diskutuar.
- 12.20 Administratori/ët do të mbledhin vendimet e miratuara apo të refuzuara dhe do të njoftojnë ortakët mbi rezultatet e vendimit qarkullues me shkrim duke treguar ortakët që janë shprehur pro, ata që janë shprehur kundër dhe ata që kanë abstenuar, dhe vlerën e kapitalit të

përfaqësuar nga secili prej tyre si dhe datën në të cilën është miratuar vendimi. Konsiderohet si datë e miratimit të vendimit data në të cilën mbaron afati i treguar në propozim.

- 12.21 Administratorët dhe/ose ortakët kanë të drejtë të kontrollojnë të gjithë dokumentet lidhur me çdo vendim qarkullues me shkrim.

### SEKSIONI III ADMINISTRATORI

#### Neni 13 – Administratori i Përgjithshëm

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të Shoqërisë, sipas Nenit 81 paragrafi 1, pika 3 de Neni 95 të Ligjit. Emërimi dhe caktimi i afatit të emërimit i nënshtrohet individualisht një vendimi të zakonshëm i cili, nëse miratohet çon në zgjedhjen e personit të propozuar si Administrator.
- 13.2 Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë persona të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë 5 vjeçare. Veprimet e ndërmara nga Shoqëria kërkojnë nënshkrimin e Administratorit ose të njërit nga Administratorët sipas kufizimeve dhe kompetencave të shprehura në Vendimin e Asamblesë.
- 13.3 Shoqëria do të administrohet për një periudhë 5 vjeçare nga momenti i nënshkrimit të Statutit, me të drejte ripërsëritje nga Administratori:

- **Znj. Enkeleda Kuka**, shtetase shqiptare, e bija e Ademit, e datëlindjes 12.01.1973, lindur në Burrel dhe banues në Tiranë, Rruga “Perlat Rexhepi”, Nd. 1 H. 6, ap. 29, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me anë të Letërnjoftimit ID me nr. personal H35112041E;

#### Neni 14 – Kompetencat e Administratorit

- 14.1 Administratori i Përgjithshëm është përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë dhe përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në përputhje me dispozitat e Statutit ose ligjit të zbatueshëm. Administratori ka të gjitha kompetencat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme për administrimin e Shoqërisë, përveç atyre që sipas Statutit ose ligjit të zbatueshëm i takojnë Asamblesë së Përgjithshme. Në rast të më shumë se një Administratori, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një ose më shumë Administratorë mund të veprojnë bashkarisht ose veç e veç.
- 14.2 Administratori ka kompetencat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:
- të përfaqësojë Shoqërinë në marrëdhënie me të palët e treta.*
  - të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të Nenit 95 të Ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare;*
  - të përfaqësojë shoqërinë, në mënyrë aktive ose pasive, përpara çdo autoriteti gjyqësor, administrativ, fiskal, në çdo procedurë, në çdo shkallë të gjykimit, si në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj, me të drejtën për të nënshkruar çdo akt ose dokument të nevojshëm sipas rastit, personalisht ose duke ndjekur formalitetet përkatëse, pra, edhe me lëshimin e prokurave, mandateve të veçanta për avokatë, mbrojtës, të përgjithshme dhe për mosmarrëveshje; të lëshojnë ose të revokojnë mandate ad lites avokatëve dhe*



- mbrojtësve dhe ad negotia punonjësve të shoqërisë ose të tretëve për një ose më shumë veprime, në kuadër të kompetencave përkatëse;*
- d. të kryejë çdo operacion financiar dhe/ose tregtar, të kryejë transaksione financiare, të kryejë veprimet e nevojshme për dhënie dhe marrjen e huave nga institucionet financiare, individe, apo subjekte të ndryshme, duke nënshkruar marrëveshje deri në vlerën 500,000 Euro, dhe të kryejë çdo transaksion që ka lidhje me operacione që hyjnë në objektin e shoqërisë, duke marrë përsipër angazhime dhe përmbushje të formaliteteve të nevojshme, etj.*
  - e. të çelë llogari rrjedhëse bankare, të kryejë tërheqje parash, të japë dispozita të pagesës, të firmosë çeqe që të kenë vlerë tek këto llogari rrjedhëse, edhe të zbuluar, në kufijtë e besueshmërisë së atij momenti (overcover), të verifikojë këto llogari rrjedhëse dhe të miratojë llogarinë;*
  - f. të punësojë, të pezullojë, të zgjidhë marrëdhëniet e punës, të përcaktojë pagat e punonjësve dhe të ndryshojë kushtet që lidhen me marrëdhënien e punës së personelit;*
  - g. të ndërveprojë me Entet e Administratës Publike për çdo negociim që lidhet me oferta, projekte, pjesëmarrje, gjithnjë brenda kufijve të parashikuar nga objekti i shoqërisë;*
  - h. të lëshojë ekstrakte të borderove dhe vërtetime që lidhen me personelin, si për entet e sigurimeve shoqërore, ashtu dhe për ente të tjera ose private; të kujdeset për respektimin e përmbushjeve, ndaj të cilave shoqëria është e detyruar, me të drejtën për të nënshkruar deklarata tatimore, që kanë lidhje me mbajtjet nga të ardhurat e punës së varur ose autonome që janë përdorur;*
  - i. të nënshkruajë deklarata fiskale në lidhje me taksat dhe tatimet në përgjithësi, si dhe çdo akt ose certifikatë të parashikuar nga legjislacioni fiskal në fuqi, të kërkojë rimbursime dhe lehtësime nga taksat dhe tatimet, të përfaqësojë shoqërinë përpara organeve të administratës fiskale dhe pranë komisioneve tatimore të çdo shkalle, me të drejtën për të emëruar mbrojtës të posaçëm;*
  - j. të përfaqësojë shoqërinë pranë organeve publike, tatimore dhe administrative, edhe me qëllim fitimin e konçesioneve, liçencave dhe lejeve, duke emëruar, nëse është e nevojshme edhe mbrojtës të posaçëm;*
  - k. të nënshkruajë komunikimet e bankës mbi kryerjen e akreditimit dhe borxhit në llogari rrjedhëse dhe ekstrakteve periodike të llogarive rrjedhëse për vartësit e shoqërisë për shumat e depozituara pranë saj;*
  - l. të nënshkruajë kontrata shitblerje të mallrave dhe shërbimeve, në kufijtë e objektit të shoqërisë;*
  - m. të ndërtojë, të përfundojë dhe të administrojë marrëdhënie bankare, duke rënë dakord mbi afatet dhe kushtet;*
  - n. të kryejë çdo formalitet për firmosjen e një akti dhe/ose dokumenti me qëllim depozitimin e akteve dhe dokumenteve të shoqërisë pranë Gjykatës, Dhomës së Tregtisë, Zyrave Fiskale dhe Enteve të tjera;*
  - o. të përfaqësojë shoqërinë në asambljetë e shoqërive të tjera, shoqatave, konsorciumeve dhe në marrëdhëniet me këto ente, organet e tyre dhe ortakët ose të asociuarit e tyre, dhe të emërojë përfaqësues, të delegojë me mandat dhe/ose prokurë, aq sa i takon kompetencave të tij.*
  - p. është përgjegjës për zbatimin e të gjitha kërkesave ligjore në fuqi, ashtu si edhe për respektimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, për zbatimin e të gjitha rregulloreve të Shoqërisë.*



- q. është përgjegjës individualisht, ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.
- r. është përgjegjës të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- s. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në keto dispozita.
- t. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- u. të parandalojë dhe mënjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë.
- v. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- w. të ushtrojë çdo të drejtë ose detyrë tjetër të caktuar nga ligji ose Statuti.
- 14.3 Administratori i Shoqërisë mund të caktojë një perfaqësues “ad negotia” për kryerjen e detyrave ose të kategorive të veçanta të detyrave sipas kompetencave të përcaktuara me ligj ose në këtë Statut.
- 14.4 Administratori i Shoqërisë mund të largohet nga detyra kur përfundon afati i emërimit, ose në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, ose kur jep dorëheqjen.
- 14.5 Të gjitha aktet e kryera nga Administratori ose nga një person që ushtron detyrën e caktuar nga Administratori, pavarësisht faktit nëse më vonë zbulohet se ka pasur mangësi në emërimin e tij ose ka qenë i skualifikuar nga e drejta për të mbajtur detyrën ose nuk ka pasur të drejtë vote, janë të vlefshëm njësoj sikur të gjithë këta persona të ishin emëruar rregullisht, të plotësonin kushtet, të vazhdonin të ishin Administratorë.
- 14.6 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

#### SEKSION IV ADMINISTRIMI FINANCIAR I SHOQËRISË

##### **Neni 15 – Eksperti Kontabël i Autorizuar**

- 15.1 Ekspertë kontabël të autorizuar kryejnë funksionet e kontrollit financiar në përputhje me ligjin Shqiptar
- 15.2 Ortakët duhet të emerojnë ekspertë kontabël të autorizuar në numrin dhe për kohëzgjatjen e përcaktuar nga ligji shqiptar
- 15.3 Kontrolli i brendshëm i Shoqërisë do të kryhet nga një ose më shumë Ekspertë kontabël të autorizuar të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme për një vit financiar.

#### TITULLI V VITI FINANCIAR, FITIMET

##### **Neni 16 – Viti Financiar dhe Mbajtja e Llogarive**



- 16.1 Viti financiar fillon me në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti. Viti i parë financiar fillon në ditën e parë që është themeluar Shoqëria.
- 16.2 Shoqëria mban financat në lekë dhe mban bilancin dhe llogaritë në përputhje me ligjin në Shqipëri. Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet çdo muaj, në monedhën vendase.
- 16.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj, prandaj Shoqëria mund të vendosë barrë siguroese mbi kuotat si garanci, ose mund të vendosë pasuri të paluajtshme apo asete si garanci, me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 17 - Fitimet**

- 17.1 Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të shpallë dividendë në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 17.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumatat e paguara për kuotat në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim me shumatat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuotat emetohen me kushtin se merr dividend, duke filluar nga një datë e caktuar atëherë kuota në fjalë e merr dividendin sipas këtij kushti.
- 17.3 Fitimet që rezultojnë nga pasqyrat e llogarive vjetore, pas zbritjes së të gjitha shumave, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme rezervohen ose shperndahen.
- 17.4 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për krijimin e një rezerve të jashtëzakonshme ose të veçantë.

### **TITULLI VI SHPERNDARJA – NDARJA – SHKRIRJA, LIKUIDIMI**

#### **Neni 18 - Shpërndarja – Ndarja – Shkrirja**

- 18.1 Shoqëria shpërndahet në rethanat e parashikuara nga ligji i zbatueshëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
  - a. Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar për themelimin e saj;
  - b. Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
  - c. Me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - d. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i saj në QKB;
  - e. Me vendim të Gjykatës;
- 18.2 Shoqëria, gjithashtu mund të ndahet ose të shkrihet me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 18.3 Administratori regjistron prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me Nenin 43 të Ligjit Nr. 9723, Dt. 3.05.2007.

#### **Neni 19 – Likuidimi**



- 19.1 Kur Shoqëria shperndahet ajo duhet të likuidohet. Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesit me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund t'i shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve
- 19.2 Për administrimin e kësaj procedure, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidatorë të cilët do të kenë gjithë kompetencat dhe detyrat e parashikuara nga ligji i zbatueshëm.
- 19.3 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive të papaguara, likuidatori/et do të shpërndaje/në shumat e mbetura tek Asambleja e Përgjithshme.

#### **Neni 20 - Largimi dhe Përjashtimi i Ortakut**

- 20.1 Largimi dhe përjashtimi i Ortakut do të kryhet në përputhje me nenet 101,102 dhe 103 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

### **TITULLI VII TË NDRYSHME**

#### **Neni 21 – Ndryshimet**

- 21.1 Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht ose një statut i ri mund të miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 22 – Dispozita të fundit**

- 22.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet në menyrë specifike nga ky Statut, do të zbatohen dispozitat e Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 22.2 Ky Statut është hartuar në 3 (tre) ekzemplare në gjuhën Shqipe. Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga zbatimi dhe/ose interpretimi i këtij Statuti, do të zgjidhen nëpërmjet Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "EMS Western Balkan" sh.p.k**

**Për Ortakun "Mantic" sh.p.k**

**Nënshkruar nga përfaqësuesi**

**Z. GENTI DACI**

